



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1364 Prot.

Tiranë, më 06.11 2017

**VENDIM Nr. 216, datë 31.10.2017**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.12, datë 31.10.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të **projektit "Kompleks Turistik-Silver Sand Resort" në zonën Pulaj-Plazh, Velipojë, Shkodër**-subjekti "IMPERIAL C. CONSTRUCTION" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar Znj. Lida Miraj,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të **projektit "Kompleks Turistik-Silver Sand Resort" në zonën Pulaj-Plazh, Velipojë, Shkodër** -subjekti "IMPERIAL C. CONSTRUCTION" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar Znj. Lida Miraj.
2. Subjekti "IMPERIAL C. CONSTRUCTION" sh.p.k., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për zbatimin e projektit "Kompleks Turistik-Silver Sand Resort" në zonën Pulaj-Plazh, Velipojë, Shkodër, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë  
Tel: ++355 04 45 35 855  
email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)  
Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)